



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC
Drejtoria për Administratë të përgjithshme
Odeljenje za Opštu Upravu



-III-

Nr. I prot
Br. prot.

740

Më

14.03.20

Dt.

20

RAHOVEC - ORAHOVAC

KOMUNA E RAHOVECIT

OPSTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY OF RAHOVEC

KONTRATË

Numri i kontratës:¹ 623-25-465-2-3-6/C651

Emri i Autoritetit Kontraktues: **KUVENDI KOMUNAL - RAHOVECË**, në njërën anë; dhe

Emri i Kontraktuesit: **TMS MOBILE SH.P.K., Rr.Behar Begolli AL-Trade Obj.H/22-1, Prishtina e Re-Veternik,, Prishtine, 810828717**, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për shërbimet e shënuara me poshtë:

Titulli i Kontratës: **Vendosja e GPS-ve në veturat zyrtare**

Me numër identifikues: **623-25-465-2-3-6**

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës do të jetë: **Vendosja e GPS-ve në veturat zyrtare**, sipas specifikimeve teknike të detyrueshme dhe pjesës së ofertës financiare që janë pjesë e kësaj kontrate.

1.2 Kontrata hynë në fuqi me: **datën e nënshkrimit** dhe përfundon për një periudhë prej **12 Muaj**

1.3 Afati kohor i performances nuk mund të jetë më shumë se **[20 ditë]** nga data e marrjes së urdhëreses.

1.4 Vendi për kryerjen e shërbimeve do të jetë: **Në Komunën e Rahovecit**

1.5 Incotermi i aplikueshëm do të jetë **DDP²** (Detyra e Dërguar e Paguar).

Neni 2 Ligji i aplikueshëm

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë sipas Nenit 40 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimi total i shërbimeve duhet të jetë: **7,990.00 Euro;**

[Shtatë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë Euro e zero Cent]

¹ Ju lutemi referojuni këtij numri të kontratës në dokumentet e faturimit dhe pagesës, procedurat dhe transaksionet që lidhen me thesarin.

² DDP – Detyra e Dërguar e Paguar- Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përjashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtrohen ndryshimit të çmimit sipas berzës përkatëse, nëse aplikohet).

Neni 4 Pagesat

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

[Autoriteti Kontraktues do të paguaj secilën shumë të detyrimeve pas pranimit të secilës dërgesë]

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

Neni 6 Kualiteti

6.1 Kualiteti i shërbimeve duhet në të gjitha aspektet të plotësojë specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

Neni 7 Garancioni

7.1 Garancioni do të mbetet valid për 24 Muaj, pas pranimit të shërbimeve.

Shume e sigurisë së ekzekutimit është: **10 % e vlerës së kontratës**, për kohëzgjatjen e periudhës prej: **13 Muaj** nga data e nënshkrimit të kontratës.

Neni 8 Vonesat në ekzekutim

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin të realizojë ndonjë ose të gjitha shërbimet brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së shërbimeve të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

Neni 9 Inspektimi dhe testimi

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

Neni 10 Nën-kontraktimi

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontrakttojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia

jep dikuajt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judicata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorin Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore


13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në [Gjykata Themelore Prishtinë] në pajtim me ligjin e Kosovës.

Neni 14 Komunikimi

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin e identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

E hartuar në gjuhën [Shqip]³ në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një original për Operatorin Ekonomik.

Për Autoritetin Kontraktues:		Për Ofruesin e Shërbimeve:	
Emri:	Astrit Mullabazi	Emri:	Hajdin Çela
Pozita:	Zyrtar përgjegjës i prokurimit	Pozita:	Drejtor
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	14.03.2025	Data:	14.03.2025
Vula:		Vula:	

³ Gjuha do të jetë gjuha e përdorur nga tenderuesi në tenderin e tij.

Aneksi 1. SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME

Komuna e Rahovecit ka për synim që përmes këtij projekti të bëjë menaxhimin e automjeteve që ka në pronësi, duke menaxhuar aktivitetet e lëvizjes si nga aspekti i sigurisë, menaxhimit të drejtë të aktiviteve në terren si dhe reduktimi i shpenzimeve të mirëmbajtjes dhe shfrytëzimit të derivateve në mënyrë efikase, duke përcjellur këto aktivitete në kohë reale apo përmes raporteve në mënyrë retroaktive.

Sistemi i menaxhimit të flotës dhe përcjelljes së automjeteve është një sistem që lejon gjurmimin dhe kontrollimin e automjeteve përmes një kompjuteri apo pajisje mobile përmes satelitëve dhe sistemit të pozicionimit global (GPS). Sistemi i përcjelljes së automjeteve e bën të mundur përcjelljen e menjëhershme në kohë reale dhe të kaluarën apo retroaktive duke dhënë informatat si: shpejtësia e ngasjes, rrugët e përshkuara, ndalesat, koha e punës boshe dhe shumë raporte të ndryshme të cilat japin një siguri dhe menaxhim të mirëfillt të një flote.

Pjesa softuerike e aplikacionit – Kërkesat teknike minimale:

Arvento professional set imt. 14

Arvento driver ID unit (mdiu)

Arvento web, mobile app (ios, android).

Arvento fleet.

- Çasja në aplikacion duhet të bëhet përmes uebit në kompjuter personal dhe telefonave mobil në sistemet android dhe iOS me aplikacionin mobil përkatës.
- Administruesi i sistemit duhet të ketë mundësi të hap llogari të përdoruesëve të tjere duke ju dhënë çasje në nivele të ndryshme duke filluar nga të drejtat e plota apo të limituara dhe bazike.
- Aplikacioni duhet të jetë në gjuhën shqipe dhe angleze.
- Paneli grafik duhet të tregojë të dhëna përmbledhëse për një automjet apo për të gjithë flotën, duke dhënë informatat në numra apo grafike në formë të grafikave si distancën totale, shpejtësinë maksimale, mesatare, eco dhe safe drive, shkeljet e rregullave siç janë puna boshe, nxitimi, ngadalsimi, shpejtësia etj
- Moduli i menaxhimit të flotës duhet të mundësojë regjistrimin e punëve periodike të automjeteve si servisimet dhe mirëmbajtja e tyre, shpenzimet e serviseve, sigurimi dhe regjistrimi, aksidentet, raporte financiare rreth shpenzimeve të ndryshme të automjeteve si dhe me anë të rikujtuesit “reminder” të na njoftoj rreth afateve periodike në kilometra dhe afate kohore për kryerjen e një kontrole apo procesi siç janë sigurimet, serviset etj. Menyja e shpenzimeve duhet të ketë mundësinë e zgjedhjes së automjetit në bazë të tabelave ku në menyre automatike do të shfaqen kilometrat e përgjithshme të automjetit dhe duke përcaktuar llojin e shpenzimit siç janë: vaji, gomat, frenat dhe shpenzime tjere, duke futur të dhënat e futurës siç është numri, shuma e futurës etj.

Menyja e kërkesave (fletë udhëtimi) duhet të mundësojë paraqitjen e kërkesave që kanë të bëjnë me automjetet të cilat kërkohen nga stafi dhe kërkesa e tyre duhet të aprovohet apo refuzohet nga menaxheri përkatës. Kjo kërkesë duhet të përmbajë kolonat si numri i udhëtimit, departamenti në të cilën bëhet kërkesa, vendi i nisjes dhe destinimit, koha e nisjes së rezervimit dhe përfundimit, si dhe kilometrat e nisjes dhe përfundimit të udhëtimit.

Përkujtimi (reminder) duhet të ketë mundësinë të dërgohet edhe përmes postës elektronike (e-mail) personave të ndryshëm përgjegjës siç janë: gjambat në trafik, sigurimi i automjeteve, kontrollimi teknik, mirëmbajtja etj.

Menyja e aksidenteve duhet të jetë nën vetë, ku duhet të përmbajë kolonat si zgjedhja e automjetit, data e aksidentit, lloji i aksidentit, vozitësi, numri i raportit, vozitësi i veturës tjetër në aksident, fajtori i aksidentit primar dhe sekondar, kolona e përcaktimit të kompanisë sigurorese, shuma e rimbursimit dhe shuma e pagesës nga kompania e sigurimeve.

Administrimi i modulit të menaxhimit të flotës duhet të ketë mundësi të zgjidhet përdoruesi, duke i dhënë çasje dhe drejta të ndryshme për përdorimin e këtij moduli.

Numri i Prokurimit: 623.25.002.2-3-6 – Titulli: Vendosja e GPS–ve në veturat zyrtare

- Aplikacioni duhet të dërgoj të dhëna për një periudhë prej më pakë se 5 sekonda nëpërmjet komunikimit GPS-GPRS duke dhënë informata të sakta për vozitësin e makinës, llojin e makinës, targat, të dhënat e, shpejtësinë e lëvizjes në kohë reale, statusin e makinës se a është në lëvizje, ndalur, apo puna boshe.
- Aplikacioni duhet të posedoj hartat siç janë; Google map, google hybrid, layer 4 maps dhe hartat dixhitale të licencuara.
- Aplikacioni duhet të ketë vegla manipuluese për çasje të shpejtë në funksionalitet si: rritjen dhe zvogëlimin e hartës (zoom-in, zoom-out), matja e gjatësisë së rrugës, ndarja e ekranit deri në katër pozicione të ndryshme të hartave në mënyrë që të ketë mundësi të monitorohet në disa rajone apo qytete të ndryshme njëkohësisht etj.
- Autorizimet e nivelit të çasjes duhet të grupohen si: përdoruesi kryesor i cili ka mundësi të hap llogari tjera dhe të ketë të drejtë çasje të plota, përdoruesi i raporteve i cili ka çasje vetëm në gjenerimin e raporteve dhe përdoruesi i kufizuar i cili ka mundësi të shoh automjetet.
- Aplikacioni duhet të na informojë se është humbur korrespondenca me makinë, duke na dhënë alarm në sistem dhe duke dërguar mesazh përmes postës elektronike apo sms.
- Aplikacioni softuerik duhet të ketë mundësinë e shfaqjes së të dhënave dhe raporteve në mënyrë retroaktive deri në 5 vite dhe të gjeneroj ato në PDF, Excel dhe direkt në ekran.
- Raportet e bazuara në grafikë duhet të shfaqin të dhëna të grafikëve të avancuara si distanca ditore apo javore e përgjithshme dhe për secilën veturë veç e veç, distanca mesatare, përqindja e ndryshimit të distancës nga periudha e kaluar, grafikoni i avancuar për shkeljet e rregullave si puna boshe e veturës, shkeljet e shpejtësisë, nxitimi dhe ngadalsimi i vrullshëm i veturave.
- Aplikacioni duhet të dërgoj raporte në mënyrë periodike përmes postës elektronike.
- Ndarja e raporteve duhet të jetë si në vijim:

Raporti gjeneral – përmes këtij raporti shfrytëzuesi mund të zgjedh një apo më shumë vetura, ku zgjedhja mund të bëhet përmes emrit të vozitësit, targave, veturës apo një grupi. Pastaj do të ketë mundësinë të zgjedh perudhën e dëshiruar të gjenerimit të raportit përmes datës, orës dhe ditëve të javës. Gjithashtu zgjedhja e llojit të alarmeve do të bëhet duke selektuar llojin e alarmeve si: Alarmi emergjent, alarmi i lëvizjes, alarmi i pausës, alarmi i shpejtësisë, alarmi i shpejtësisë brenda dhe jashtë qytetit, alarmi i shpejtësisë në autostradë, alarmi i dytë i shpejtësisë, dalja nga rajoni, dalja nga rruga, alarmi i tërheqjes së veturës, lidhja e GPRS, hyrja në rajon, hyrja në rrugë, hapja dhe mbyllja e kapkut të pajisjes, alarmi i mundësisë së aksidentit, alarmi i nxitimit dhe ngadalsimit të vrullshëm, alarmi për të treguar që pajisja filloj të punoj me bateri të pajisjes, u largua dhe u vendos kartela e vozitësit etj.

Raportet përmbledhëse – statusi gjeneral për 7 ditë, raporti operimit të automjeteve, raporti i punës boshe, raporti i distancës, raporti i distancës bazuar në kohë.

Raportet e Alarmeve - alarmi i pausës, alarmi i punës boshe, alarmi i lëvizjes, nxitimit dhe ngadalsimit të vrullshëm, alarmi i tërheqjes së veturës, detektimit të aksidentit, ndezjes së veturës etj.

Raportet e shpejtësisë – alarmi i shpejtësisë, kohëzgjatja e tejkallimit të shpejtësisë, alarmi i parë dhe i dytë i shpejtësisë etj.

Raporti i sistemit – kyçja dhe çkyçja në sistem.

- Përcaktimet duhet të bëhen përmes menysë të veçantë duke përcaktuar:
 - Veturën – targat, fotografa e veturës, brendi dhe modeli i veturës, lloji i karburantit, numri i shasisë, lloji i motorit, ngarkesa e lejuar etj.
 - Shoferët/nagsësit – Fotografia e ngasësit, numri identifikues dhe numri personal, numri i telefonit, adresa dhe të dhënat e identifikuesit RFID.
 - Shabllonet – Përcaktimi i konfigurimeve shabllon, të cilat konfigurime mund të barten lehtë tek të gjitha automjetet apo një grup i caktuar.
 - Përcaktimet e kontakteve – përdoruesëve të raporteve dhe kontaktet e tyre.
- Aplikacioni duhet të ketë një meny me çasje të shpejtë në listen e veturave ku në atë meny duhet të jenë informatat si targat e veturës, ngasësi, lokacioni dhe koordinatat momentale, kilometrat ditore të përshkuara, shpejtësia momentale. Pas selektimit të një veture duhet të shohim të gjitha aktivitetet e saj si niveli i karburantit, regjistri i alarmeve, konfigurimet direkte të pajisjes, historia e veturës për një periudhë të caktuar kohore, duke shfaqur historinë e rrugës dhe lëvizjes së veturës në atë rrugë dhe statistikat tjera si mesatarja e shpejtësisë etj.

Numri i Prokurimit: 623.25.002.2-3-6 – Titulli: Vendorsja e GPS–ve në veturat zyrtare

- Duke klikuar mbi ikonën e një automjeti në hartë, duhet të shfaqet mundësia e zgjedhjes së periudhës së historisë dhe aktiviteteve të asaj veture, duke shfaqur rrugën e përshkruar në atë periudhë në hartë dhe duke shfaqur të gjitha aktivitetet e ndaljes, fikjes së automjetit, ndezjes, lëvizjes, tejklimi i shpejtësisë, gjithashtu të shfaqen të dhënat në formën e grafikoni, duke treguar me ngjyrë, përqindje dhe kohë aktivitetet si: kohëzgjatja e ndaljes, kohëzgjatja e lëvizjes dhe kohëzgjatja e punës boshe të automjetit. Kjo rrugë e përshkruar mund të demonstron se si ka lëvizur automjeti në hartë nëpër atë rrugë.
- Automjeti duhet të shënohet me ikona në formë të pikave, dhe këto pika duhet të tregojnë statusin e aktivitetit momental siq janë: ngjyrë e kaltërt apo e gjelbërt duke lëvizur, ngjyrë e kuqe kur është ndalur, e zezë apo hiri kur humbet sinjali me pajisjen, etj.
- Softueri dhe hardueri duhen të kenë certifikata të kualitetit ISO 9001 dhe sigurisë të dhënave ISO 27001 dhe ISO 14001.

Pjesa harduerike (Pajisja për gjurmimin e makinës) – Kërkesat teknike minimale:

- Pajisja për gjurmim të automjetit duhet të ketë së paku 4 njësi hyrëse dixhitale dhe 3 njësi hyrëse analoge, 1 njësi hyrëse/rrugëmatës (odometerinput), 1 njësi hyrëse për ndezje (ignitioninput), 2 njësi dalje dixhitale, 1 port audio, 1 sensor I2C, 1 port canbus.
- Pajisja duhet të jetë e instaluar në një vend në makinë dhe duhet të jetë e padukshme nga jashtë;
- Pajisja duhet të jetë e fuqishme për të përballuar dridhjet, goditjet, etj.
- Pajisja duhet të operojë në temperaturat nga -35 C deri në + 80 C;
- Pajisja duhet të punojë me të gjitha kartat SIM të operatorëve të ndryshëm GSM në Kosovë duke ndryshuar informacionin APN; (kartat SIM do të sigurohen dhe mbushen/abonohen me internet nga Autoriteti kontraktues)
- Antena GPS dhe GSM duhet të jenë të brendshme.
- GSM modemi duhet të jetë e integruar në brendi të pajisjes dhe duhet të mbështesë GSM 900, GSM 1800 dhe GSM 1900Mhz
- Pajisja duhet të ketë mundësinë të fiket një automjet nga distance (remote engine block).
- Pajisja duhet të punojë në mes 12-24 VDC;
- Pajisja duhet të ketë memorie të brendshme për të ruajtur të dhëna mbi lokacionin;
- Prodhuuesi i pajisjeve dhe i softuerit duhet të ofrojë certifikate valide për menaxhim të cilësisë ISO 9001 si dhe 27001 për siguri të dhënave dhe ISO 14001.
- Pajisjet duhet të jenë të prodhuara në EU.
- Pajisja duhet të mbështesë CANbus dhe integrimin me OBD.
- Pajisjet duhet të kenë të integruar G-Sensorin për zbulimin e lëvizjeve dhe aksidenteve
- Firmware i pajisjes duhet të jetë në gjendje të ripërtërihet (update) nga distanca nga qendra e monitorimit nëpërmjet GPRS (Firmëareover the air – FOTA).
- Pajisjet duhet të ketë një sensor i cili përmes sistemit tregon kur do të hapet apo mbyllet kapaku i pajisjes, në rast se personat e pa autorizuar tentojnë të hapin pajisjen për qëllime të ndaljes së funksionimit apo dëmtimit të saj (tamper detection).
- Pajisja duhet të ketë Li-Ion bateri minimum 850mAh që ndihmon pajisjen për të mbajtur në punë pajisjen në rast të dështimeve elektrike;

PËRFORMANCA:

1. Ofertuesi duhet të ofrojë përkrahje teknike dhe gjithashtu në ofertë të ceket koha e përgjigjes dhe zgjidhja e prishjes gjatë ditëve të punës dhe fundjavave, festave etj.
2. Ofertuesi duhet të ofrojë numër thirrës për prishjet e mundshme, person kontaktues dhe disponueshmëri për pranimin e thirrjeve;
3. Ofertuesi duhet të bëjë eliminimin e prishjes apo pajisjes së tij në kohë max 5 ditë.

Numri i Prokurimit: 623.25.002.2-3-6 – Titulli: Vendorsja e GPS-ve në veturat zyrtare

4. Ofertuesi duhet ofroj Autorizim të Prodhuesit (MAF) origjinal për harduerin dhe softuerin duke ju referuar projektit në fjalë (Autoriteti kontraktues, titulli i projektit dhe numri i prokurimit).
5. Ofertuesi duhet të ketë të paktën një kontratë të dëshmuar me referencë të përfunduar me sukses në ndonjë kompani tjetër për një numër më të madh se 100 makina.
6. Ofertuesi duhet të ketë staf të certifikuar minimum 5 persona nga prodhuesi i pajisjeve dhe softuerit. Të ofrohen certifikatat valide, ku njeri nga te jete i certifikuar per instalim te senzoreve te derivateve dhe njeri nga ta per trajnime.
7. Ofertuesi duhet të ofrojë katalog origjinal te prodhuesit të detajuar me specifika për produktet e ofruara për pjesen harduerike dhe softuerike.
8. Ofertuesi në specifikacion teknik Aneks 1, duhet të specifikoj saktë prodhuesin dhe modelet e pajisjeve dhe te përshkruaj në detaje aplikacionin të cilin e oferton si dhe prodhuesin.
9. Ofertuesi duhet të ofroj manual të përdorimit të sistemit dhe softuerit duke specifikuarsaktë mënyrën e raportimeve dhe të gjitha funksionaliteteve të cekura në këtë specifikacion.
10. Ofertuesi duhet të ofroj certifikatat për pjesën e harduerit dhe softuerit siq janë ISO 9001, ISO 27001 dhe ISO 14001.
11. Autoriteti kontraktues do të ftoj ofertuesin për prezantim dhe demonstrim te funksionit te aplikacionit dhe pajisjeve, gjatë fazës së vlerësimit, para dhënies së kontratës.
12. Koha e liferimit, instalimit të pajisjeve dhe sistemit duhet të jetë 20 ditë kalendarike nga moment i nënshkrimit te kontratës.
13. Dokumentacioni i kërkuar tek pjesa e performancës është obligative të dorezohet gjatë fazës së tenderimit.

Trajnimet në përdorimin e pajisjeve dhe aplikacionit:

- Ofertuesi duhet të mbajë një kurs të plotë trajnimi lokal për të paktën (5) persona mbi instalimin, mirëmbajtjen, administrimin dhe servisimin për pajisjet dhe aplikacionin e ofertuar;

PAJISJET:

Nr.	Përshkrimi furnizimeve	njësia	Sasia
Furnizimi dhe instalimi i GPS sistemit dhe mirembajtja e aplikacionit			
1	Shfrytëzim i Softuerit dhe mirëmbajtje	muaj	12
2	Casja, abonimi dhe shfrytezimi i sistemit	Cope	1
3	GPS - Pajisjet	cope	22
4	Montimi i pajisjeve GPS ne automjete	cope	22

Të gjitha pajisjet do të instalohen nga Ofertuesi dhe duhet të jenë nën garancinë për 24 muaj. Garancinë të jetë i konfirmuar nga prodhuesi për projektin në fjalë (origjinal).

Përshkrimi i Çmimeve - Vendorsja e GPS-ve në veturat zyrtare

Nr.	Përshkrimi furnizimeve	njësia	Sasia	Çmimi njësi	Çmimi total
Furnizimi dhe instalimi i GPS sistemit dhe mirëmbajtja e aplikacionit					
1	Shfrytëzim i Softuerit dhe mirëmbajtje	muaj	12	€ 42,37	€ 508,47
2	Casja, abonimi dhe shfrytëzimi i sistemit	Cope	1	€ 3.559,32	€ 3.559,32
3	GPS - Pajisjet	cope	22	€ 114,41	€ 2.516,95
4	Montimi i pajisjeve GPS ne automjete	cope	22	€ 8,47	€ 186,44
				TOTALI	6.771,19 €
				TVSH	1.218,81 €
				TOTALI I OFERTËS ME TVSH	7.990,00 €

Identifikimi i Operatorit Ekonomik (OE)	
Emri i OE:	TMS Mobile Sh.P.K
Adresa e plotë:	Rr. Behar Begolli, Prishtine
Përfaqësuar nga:	
Emri	Hajdin ÇELA
Pozita	Drejtor
Nënshkrimi	
Data	05.02.2025
Vula	